



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1794 prot.

Shkodër, më 27.01. 2026

VENDIM

Nr. 7, datë 26.01.2026

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR, PËR AKORDIMIN E NDIHMËS
FINANCIARE NË FAVOR TË FAMILJES ANDI ÇEKAJ DHE HAMIDE TUZI,
BANESA E TË CILËVE ËSHTË DËMTUAR NGA ZJARRI**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës **26.01.2026**, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”; ligjin nr. 68/2017, “Për financat vendore”, i ndryshuar; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012, “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar; si dhe vendimin e Këshillit Bashkiak Shkodër nr. 84, datë 18.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër”; si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për akordimin e ndihmës së menjëhershme financiare në favor të familjes Andi Çekaj (5 anëtarë familje), në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, sipas certifikatës familjare të paraqitur, për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër për familjen Andi Çekaj, ku vlera e dëmit nga ana ndërtimore është **1 270 783 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre) lekë**, dhe vlera e dëmeve në orëndi është **944 200 (nëntëqind e dyzet e katër mijë e dyqind) lekë**, sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve pranë Bashkisë Shkodër.
3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për akordimin e ndihmës së menjëhershme financiare në favor të familjes Hamide Tuzi (1 anëtar familje), në vlerën 20 000 (njëzet

mijë) lekë, sipas certifikatës familjare të paraqitur, për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.

4. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar për familjen Hamide Tuzi, ku vlera e dëmit nga ana ndërtimore është **841 432 (tetëqind e dyzet e një mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekë**, dhe vlera e dëmeve në orendi është **544 400 (pesëqind e dyzet e katër mijë e katërqind) lekë**, sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve pranë Bashkisë Shkodër.
5. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile, i parashikuar në programin AB141 “Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile”, në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2026, të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër”, në programin AB141, Q2 O1 A5 “Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën **120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë**. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme.
6. Kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore dhe i dëmeve në orendi e pajisje për familjet **Andi Çekaj dhe Hamide Tuzi** do të kryhet sipas preventivave të vlerësimit të hartuara nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 41, të VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012, pika 3, dhe të VKM-së nr. 414, datë 08.07.2021, pika 3.1/a, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, sipas relacionit bashkëlidhur, në masën **50 % të vlerës ndërtimore**, në shumën **1 056 108 (një milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tetë) lekë**, dhe në masën **50 % të vlerës së dëmeve në orendi**, në shumën **744 300 (shatëqind e dyzet e katër mijë e treqind) lekë**, pas akordimit të fondeve nga **Ministria e Mbrojtjes**, përmes Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 37 vota

Vota Pro	37
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	27.01.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj



Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al